



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

***BURSAT E EPLO “EUROPEAN PUBLIC LAW ORGANISATION” DHE ELGS
“EUROPEAN LAW AND GOVERNANCE SCHOOL”***

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë ka përcjellë njoftimin mbi bursat që ofron EPLO “European Public Law Organization” e cila ka krijuar universitetin e saj që funksionon si një Universitet Ndërkombëtar në iniciativën për arsimin e lartë të quajtur ELGS “European Law and Governance School”.

EPLO është një organizatë ndërkombëtare në të cilën janë pjesë 17 shtete përfshirë dhe Shqipërinë. Ajo ka për qëllim formimin dhe shpërndarjen e njohurive të së drejtës publike dhe qeverisjes, si dhe promovimin e vlerave ndërkombëtare dhe evropiane.

Duke marrë në konsideratë që Shqipëria është anëtare e EPLO, si dhe duke vlerësuar nivelin shumë të mirë të nxënësve shqiptarë në shkollat greke, ELGS ka shprehur dëshirën të bashkëpunojë me universitete shqiptare, të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta dhe të përfshijë studentë shqiptarë në këtë universitet.

EPLO dhe ELGS ofrojnë bursa për student nga Shqipëria dhe nga komuniteti Shqiptar në Gëqi, konkretisht 20 bursa të plota dhe 20 bursa të pjesshme për çdo nivel universitar dhe pasuniversitar.

Të interesuarit duhet të aplikojnë **brenda muajit maj 2022**, direkt duke përcjellë dokumentacionin e duhur pranë ELGS.

Më tepër informacion mbi bursat jepet në adresat elektronike www.elgs.eu dhe www.eplo.int.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS